



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 140

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “FRYMA E RE DEMOKRATIKE”, PËR REGJISTRIMIN
SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1363 Prot., datë 6.3.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Fryma e Re Demokratike”, me kryetar z. Sali Shehu

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Fryma e Re Demokratike” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia politike “Fryma e Re Demokratike”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Sali Shehu, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.



Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 02.03.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia politike “Fryma e Re Demokratike”, me iniale “FRD”, me kryetar z. Sali Shehu rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është partia politike “Fryma e Re Demokratike” me shkronja nistore “FRD”, me adresë Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Sali Shehu, me adresë Rruga “George W Bush”, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është znj. Xhuliana Kume, me adresë Rruga “George W Bush”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Alfred Feto, me adresë Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia politike “Fryma e Re Demokratike”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia politike “Fryma e Re Demokratike”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 9 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Fryma e Re Demokratike”, me kryetar z. Sali Shehu, me shkronjat nistore “FRD”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI